Efiçienca e buxhetit të Bashkisë Vau i Dejës
(Viti 2019)

1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2019

Studimi ka për qëllim të analizojë efiçiencën dhe shpenzimet e të ardhurave për vitin 2019, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.
Projekti financohet nga UNDEF dhe zbatohet nga ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit) dhe EIC (Economic Intelligence Center) Korçë.
Bazuar në Ligjin nr. 9632, "Për sistemin e taksave vendore", bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë. Ndërsa transfertat janë fonde, të cilat u delegohen bashkive sipas parashikimeve ligjore dhe funksioneve shtesë që mori pushteti vendor nga Reforma Administrative Territoriale.
Më poshtë jepen të ardhurat totale të bashkisë:

Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve

Burimet e financimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 $ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	163,175	1,584,223	20%
Transfertë e Pakushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	212,706	2,065,107	27%
Transfertë Specifike (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	101,338	983,864	13%
Transferta e Kushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	322,784	3,133,825	40%
TOTALI	**800,003**	**7,767,019**	**100%**

Burimi: Bashkia Vau i Dejës (llogaritje EIC)

Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Vau Dejës 2019



Burimi: Bashkia Vau i Dejës (llogaritje EIC)

2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Vau i Dejës për vitin fiskal 2020

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?
Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2019. Më poshtë po japim tabelën përmbledhëse të shpenzimeve:

Tabela 2. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale

Emërtimi i shpenzimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 $ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Shpenzime Paga + Sigurime	239,802	2,328,175	30
Shpenzime operative	146,865	1,425,874	18
Investime	90,552	879,146	11
Transferta	322,784	3,133,825	40
TOTALI	**800,003**	7,767,019	100

Burimi: Bashkia Vau i Dejës (llogaritje EIC)

Figura 2. Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale



Burimi: Bashkia Vau i Dejës (llogaritje EIC)

Figura 3. Shpenzimet për paga/sig. shoqërore si raport mbi të ardhurat lokale



Burimi: Bashkia Vau i Dejës (llogaritje EIC)